



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 157 Prot.

Tiranë, më 30. 01. 2019

V E N D I M

Nr. 15, Datë 30. 01. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 158, datë 03.10.2018, e e Shoqatës “Ilinden”¹-Tiranë, kundër Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” (në vijim IMK), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se IMK, në muajin Qershor 2018, ka publikuar një broshurë, në të cilën përshkruhet zona rreth Liqenit të Ohrit, vlerat historike, kulturore dhe natyrore të saj, si dhe ndër të tjera popullsia që banon në këtë zonë. Në faqen 8 (tetë) të broshurës, citohet²: “Ndonëse këtu jeton një komunitet nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, ne mund të flasim shqip me të gjithë”. Etiketimi i minoritetit maqedonas në këtë broshurë si *komunitet nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, sipas subjektit ankues konsiderohet një fyerje për dinjitetin maqedonas në Republikën e Shqipërisë.

Në përfundim, Shoqata Maqedonase “Ilinden”, ka kërkuar që IMK të marrë masa për tërheqjen e broshurës dhe korrigjimin e saj nga “komunitet nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë” në “minoritet kombëtar maqedonas”.

¹ Përfaqësuar nga Kryetari i saj, N. Gj.

² Në gjuhën maqedonase “Иако овде живее заедница од Поранешна Југословенска Република Македонија, можеме да зборуваме албански со сите”, të përkthyer nga N. Gj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Etnia, është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Plotësimi i kriterëve formale të një ankesë, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

a)

b) *legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.*

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitimit edhe kur pala legjitimohet për të

³ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t'i referohemi ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

"1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj."

Referuar parashikimit të gërmës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi.

"Interesi i ligjshëm" është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimitimin e saj në kryerjen e ankesës.

Nëse do t'i referohemi Vendimit nr. 2473, datë 06.02.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilit Shoqata "ILINDEN" është regjistruar si person juridik, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është: *"Mbrojtja e identitetit etnik, kulturor dhe fetar të minoritetit maqedonas në Shqipëri"*.

Mbështetur në përmbajtjen e gazetës së publikuar më datë 30.06.2018 në faqen e facebook-ut të **Lake Ohrid Heritage**⁴, në faqen 8 (tetë), citohet⁵: *"Ndonëse këtu jeton një komunitet nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, ne mund të flasim shqip me të gjithë"*.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhënie me organet shtetërore shqiptare dhe mbështetur në objektin e veprimtarisë së Shoqatës "ILINDEN", të përcaktuar saktësisht në vendimin nr. 2473, datë 06.02.2009, të

⁴ https://www.facebook.com/LakeOhridHeritage/?epa=SEARCH_BOX

⁵ Në gjuhën maqedonase "Иако овде живее заедница од Поранешна Југословенска Република Македонија, можеме да зборуваме албански со сите", të përkthyer nga N. Gj.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioneri gjykon se Shoqata në fjalë, përfaqësuar nga G. Gj. legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së identitetit etnik e më gjerë, të popullit maqedonas.

2. Përsa më lart, me anë të shkresës Nr. 1354/1 prot., datë 18.10.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, në të cilën kërkoi informacion mbi pretendimet e palës ankuese.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, nëpërmjet shkresës⁶ Nr. 2166/1 prot., datë 12.11.2018, informoi KMD-në se: *“...Projekti 3 vjeçar (2014-2017) “Drejtë një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe Qeveria Shqiptare (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) kishte si qëllim kryesor përgatitjen e dosjes për shpallje “Pasuri Botërore” të pjesës shqiptare të Liqenit të Ohrit si zgjerim i zonës së shpallur Pasuri Botërore në vitin 1979 “Natural and Cultural Heritage of the Ohrid Region”. Një nga qëllimet kryesore të këtij projekti ka qënë fuqizimi i bashkëpunimit midis dy shteteve sa i përket mbrojtjes dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të liqenit të Ohrit. I gjithë projekti është drejtuar dhe zbatuar nga UNESCO. Nga ana e UNESCO-s, është krijuar një faqe ëeb ku paraqiten në mënyrë transparente ecuria e projektit, dokumentat e prodhuara dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të këtij projekti. Një ndër mjetet e informimit mbi projektin është dhe Gazeta online e projektit (Lake Ohrid Region Newsletter) e cila është konceptuar si një instrument ndërgjegjësimi mbi vlerat e zonës së Liqenit të Ohrit si dhe instrument informimi mbi ecurinë e projektit të sipërcituar. Numra të kësaj gazete botohen periodikisht online dhe paraqiten në format digjital në faqen ëeb të projektit⁷. Sa më sipër, IMK⁸ është kontribues në gjithë aspektet teknike të hartimit të dosjes për shpalljen “Pasuri Botërore” si dhe institucioni kryesor kombëtar sa i përket vlerave të trashëgimisë kulturore materiale. Edhe pse, herë pas here IMK mund të ketë kontribuar në hartimin e teksteve promovuese dhe informuese mbi trashëgiminë kulturore të zonës së liqenit të Ohrit në gazetata online të projektit, IMK nuk është institucioni përgjegjës për botimin e kësaj gazete online si dhe në rastin konkret nuk është autor i tekstit me titull: “Udhëtim në rajonin e Liqenit të Prespës”, pjesë e gazetës online të muajit qershor (edicioni i verës) dhe objekt i ankesës së Shoqatës “Ilinden”. Gjithsesi, pas informacionit të marrë, IMK ka kontaktuar me UNESCO-n si institucioni që administron botimin online të kësaj gazete, duke i përcjellë shqetësimin e ngritur nga Shoqata “Ilinden” dhe të përcjellë pranë IMK-së nga ana juaj. Nga ana e UNESCO-s propozohet ndryshimi i fjalisë (objekt i ankesës): “Even though a community from former Yugoslav Republic of Macedonia lives here, we could speak Albanian with everyone”, me fjalinë: “we could speak Albanian with everyone, including the national minorities who lives there. This is a perfect example of the respect for the rich cultural diversity of the Lake Ohrid region”. Sa më sipër, ju përcjellim qëndrimin dhe propozimin e UNESCO-s*

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1354/2 prot., datë 13.11.2018

⁷ <http://whc.unesco.org/en/lake-ohrid-region>

⁸ Shkurtesë e Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”

për ndryshim të fjalisë. Në vijim të dakordësisë nga ana juaj, UNESCO do të angazhohet me ndryshimin e tekstit në gazetën online”.

3. Në vijim të korrespondecës së mbajtur me IMK-në, KMD me anë të komunikimit nëpërmjet postës elektronike më datë 06.12.2018, kontaktoi me IMK-në dhe sqaroi ndër të tjera se: “...Duke iu referuar edhe ndryshimit të propozuar nga ana e UNESCO-s, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është dakord me të, por korrigjimi duhet të bërë në të tërë tekstin e gazetës on-line në gjuhën maqedonase dhe angleze, ku citohet togfjalëshi: “komunitet nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”, si dhe gazeta on-line të jetë e përshtatur në të tre gjuhët (maqedonase, angleze dhe shqipe) njëjloj, pra të përdoret e njëjta terminologji për të identifikuar komunitetin që banon në këtë zonë....”

Në përgjigje përsa më lart, nëpërmjet shkresës⁹ Nr. 2166/4 prot., datë 17.12.2018, IMK informoi KMD-në se: “...IMK i ka përcjellë UNESCO-s dakordësinë dhe kërkesën tuaj dhe kemi marrë konfirmimin që po merren të gjitha masat për të proceduar me ndryshimet e kërkuara dhe të dakordësuara nga të dyja palët.”

4. Me anë të komunikimit me administratorët e faqes së facebook-ut **Lake Ohrid Heritage**¹⁰, më datë 24.01.2019, u arrit që të hiqej nga faqja on-line gazeta në të cilën pretendohet se ishte cituar teksti fytes për dinjitetin e minoritetit maqedonas.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Shteti shqiptar është angazhuar për të respektuar të drejtat e minoriteteve kombëtare, duke formalizuar vullnetin e vet përmes nënshkrimit më 29.06.1995 dhe ratifikimit më 28.9.1999 të Konventës Kuadër “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, e cila hyri në fuqi më 11.01.2000. Për më tepër legjislacioni shqiptar përmban bazat ligjore për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 3 të saj parashikon se “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe **bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë**”.

⁹ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1354/3 prot., datë 18.12.2018

¹⁰ https://www.facebook.com/LakeOhridHeritage/?epa=SEARCH_BOX

Në mbrojtje të parimit të barazisë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 18 të saj “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”. Në nenin 20 të Kushtetutës parshikohet shprehimisht se “1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.”.

Në nenin 20 të Kushtetutës parshikohet shprehimisht se: “1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. 2. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t’i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre”.

Bazuar në informacionin e marrë në faqen zyrtare të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, komuniteti Maqedonas i cili banon në zonën e Prespës, në territorin e Republikës së Shqipërisë, njihet zyrtarisht si Minoritet Maqedonas, i njohur nga shteti shqiptar me të drejtat për përdorimin e lirë të gjuhës amtare maqedonase, të ruajtjes e zhvillimit të traditave kulturore, zakoneve etj.

Pavarësisht faktit që gjatë procedurës hetimore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi se subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa nuk ishte Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, por nga UNESCO¹¹, një organizatë ndërkombëtare me seli në Francë¹², objektivat e e së cilës shtrihen në 5 programeve të mëdha: arsim, kulturë, shkenca natyrore, shkenca sociale dhe shkenca e njeriut, komunikimi dhe informacioni¹³.

Referuar parashikimeve të nenit 4¹⁴ të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pavarësisht faktit që nga KMD u identifikua se subjekti që pretendohet të ketë kryer diskriminimin është një organizatë e cila nuk ka seli në shtetin Shqipëtar dhe nuk gëzon mbrojtjen nga ky ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në

¹¹ United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO) e përkëthyer si (Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara) është një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara e themeluar më 16 nëntor 1945. Qëllimi i deklaruar i kësaj organizate është të kontribuojë për paqen dhe sigurinë në Botë duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar përmes arsimit, shkencës, dhe kulturës. Më tutje kërkon edhe respektimin universal të drejtësisë, ligjeve të shtetit dhe të drejtave të njeriut, liri këto themelore të shpallura në kartën e OKB-së. Është trashëgimtare e Komisionit Ndërkombëtar për Bashkëpunim Intelektual të Lidhjes së Kombeve.

¹² <http://www.unesco.org/new/en/unesco/about-us/>

¹³ <https://sq.wikipedia.org/wiki/UNESCO>

¹⁴ 1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

respektim të të drejtave të minoriteteve kombëtare, si dhe të bashkëjetesës dhe mirëkuptimit të shqiptarëve me pakicat, vijoi shqyrtimin e ankesës.

Nga hetimet e kryera dhe bashkëpunimi me Institutin e Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, rezultoi se, gazeta e publikuar në faqen e facebook **Lake Ohrid Heritage**¹⁵, u hoq nga faqja on-line.

Në interpretim të informacionit të sipërcituar, Komisioneri gjykon dhe vlerëson se kërkesa e përfaqësuesit të Shoqatës “ILINDEN”, N. Gj., është plotësuar nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës, pasi janë marrë masat për rregullimin e situatës, duke hequr nga faqja e web-it, gazetën për të cilën ishte paraqitur ankesa. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga ana e N. Gj., Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se situata e pretenduar nga ankuesi është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Përsa më sipër, Komisioneri gjykon dhe vlerëson se kërkesa e N. Gj., është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka iniciuar procedurën hetimore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 158, datë 03.10.2018, të Shoqatës Maqedonase “*Ilinden*”, kundër Institutit të Monumenteve të Kulturës “*Gani Strazimiri*”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Etnia)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

¹⁵ https://www.facebook.com/LakeOhridHeritage/?epa=SEARCH_BOX